



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Udhëzim i Zyrës Administrative

Vizitat përmes videolidhjes

Miratoi:	Administratorja, Dhomat e Specializuara të Kosovës
Data e miratimit:	23 shtator 2020
Data e hyrjes në fuqi:	23 shtator 2020
Zëvendëson:	nuk ka
Numri:	KSC-BD-34

Përmbajtja

KREU I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
PJESA 1	QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI	2
PJESA 2	PËRKUFIZIME	2
PJESA 3	PARIMET	3
PJESA 4	TË PËRGJITHSHME	3
PJESA 5	VIZITAT PËRMES VIDEOLIDHJES	3
PJESA 6	GJUHA AUTENTIKE DHE HYRJA NË FUQI	4
KREU II	LLOJET E VIZITAVE PËRMES VIDEOLIDHJES	4
PJESA 7	VIZITAT PREJ FAMILJES	4
PJESA 8	VIZITAT E MBROJTËSVE	5
PJESA 9	VIZITAT KONSULLORE	6
PJESA 10	VIZITAT E POSAÇME	6

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Pjesa 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Ky Udhëzim është lëshuar nga Administratori në pajtim me rregullën 4.2 të Rregullores së Paraburgimit për të përcaktuar procedurën e vizitave përmes videolidhjes me të paraburgosurit që mbahen në objektin e paraburgimit ("OP") të Dhomave të Specializuara që ndodhet në burgun holandez PI Haaglanden ('burgu').
2. Qëllimi parësor i vizitave përmes videolidhjes është që t'u ofrojnë të paraburgosurve mjet shtesë për ruajtjen e marrëdhënieve familjare ndërkohë që janë në fuqi masat kufizuese për vizitat personale në objektin e paraburgimit. Gjithashtu, vizitat përmes videolidhjes kanë për qëllim t'u ofrojnë të paraburgosurve mjet shtesë për të komunikuar me mbrojtësit dhe vizitorë të tjerë të caktuar, në qoftë se mjeku i Njesisë së Paraburgimit këshillon se vizitat personale në objektin e paraburgimit mund të përbëjnë rrezik për shëndetin e të paraburgosurve. Ky Udhëzim përmban:
 - a. procedurat për organizimin e vizitave përmes videolidhjes; dhe
 - b. kushtet dhe mënyrën e kryerjes së vizitave përmes videolidhjes.
3. Ky Udhëzim interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit dhe udhëzuesit e punës ose udhëzimet e miratuara ose të lëshuara në përputhje me rregullën 4 të Rregullores së Paraburgimit.

Pjesa 2 Përkufizime

Krahas përkufizimeve të rregullës 2 të Rregullores së Paraburgimit, si dhe të nenit 2 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet dhe nenit 2 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve, zbatohet edhe përkufizimi i mëposhtëm:

Vizitë përmes videolidhjes

Vizitë me të paraburgosurin që kryhet përmes videolidhjes.

Pjesa 3 Parimet

1. I paraburgosuri mund të ketë vizita përmes videolidhjes në përputhje me këtë Udhëzim në rast se:
 - a. Administratori ka autorizuar përdorimin e vizitave përmes videolidhjes në pajtim me rregullën 4.2 të Rregullores së Paraburgimit; dhe;
 - b. është e mundur të realizohet lidhja me video me vizitorin.
2. Të paraburgosurit informohen për disponueshmërinë e vizitave përmes videolidhjes në OP.

Pjesa 4 Të përgjithshme

1. Udhëzuesit e punës dhe udhëzimet për vizitat zbatohen edhe për vizitat përmes videolidhjes, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Udhëzim.
2. Vizitat tek të paraburgosurit rregullohen nga udhëzuesit e punës dhe udhëzimet e mëposhtme të miratuara ose lëshuara në përputhje me rregullën 63 dhe rregullën 4 të Rregullores së Paraburgimit:
 - a. Rregullorja e Paraburgimit;
 - b. Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet;
 - c. Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve;
 - d. Udhëzimi i Njesisë së Paraburgimit mbi Rregulloren e Brendshme të Objektivit të Paraburgimit ('Rregullorja e Brendshme');
 - e. Udhëzimi i Njesisë së Paraburgimit mbi Procedurat e Vizitave nga Anëtarë të Familjes dhe Vizitorë të tjerë Personalë; dhe
 - f. çfarëdo udhëzuesi pune apo udhëzimi tjetër i miratuar ose nxjerrë në bazë të rregullës 4 të Rregullores së Paraburgimit, duke përfshirë edhe këtë Udhëzim.
3. Të paraburgosurit dhe vizitorët e tyre zbatojnë udhëzuesit e punës dhe udhëzimet e renditura më sipër, duke përfshirë edhe këtë Udhëzim.
4. Pyetjet për procedurat e vizitave mund t'i drejtohen zyrës së administrimit të Njesisë së Paraburgimit ('zyra e administrimit') me anë të postës elektronike në: visitors-DMU@scp-ks.org.

Pjesa 5 Vizitat përmes videolidhjes

1. Vizitat përmes videolidhjes lejohen për:
 - a. të afërmit e ngushtë ('vizita prej familjes');
 - b. mbrojtësit ('vizitat e mbrojtësve');
 - c. përfaqësues konsullorë ('vizita konsullore');
 - d. KNKK-në, Avokatin e Popullit dhe autoritetet e përcaktuara në nenin 23.1 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet ('vizita të posaçme').
2. Shefi i paraburgimit mund të kufizojë orarin, numrin dhe kohëzgjatjen e vizitave përmes videolidhjes në bazë të planit ditor të punës në OP dhe disponueshmërisë së personelit dhe të mjediseve dhe pajisjeve. Shefi i paraburgimit mund të kufizojë gjithashtu edhe numrin e vizitorëve të pranishëm në një vizitë përmes videolidhjes për arsye teknike ose arsye të tjera, ndër të cilat edhe ato në interes të sigurisë në OP.
3. Para çdo vizite të planifikuar përmes videolidhjes, vizitorëve të miratuar u jepet informacion në lidhje me teknologjinë e zgjedhur për lidhjen me vizitën përmes videolidhjes. Vizitorët duhet të

Dhomat e Specializuara të Kosovës
Udhëzim i Zyrës Administrative mbi vizitat përmes videolidhjes

KSC-BD-34

- sigurojnë që të jenë në një mjedis privat përpara se të bëjnë videolidhjen. Vizitorëve do t'u kërkohet t'i japin informacione Njesisë së Paraburgimit, që të mund të vendoset videolidhja me ta.
4. Vizita përmes videolidhjes administrohet nga Njësia e Paraburgimit. Të paraburgosurit nuk prekin e as nuk përpiqen të prekin pajisjet kompjuterike ose të videos. Nëse lidhja me video shpërbëhet, i paraburgosuri njofton oficerët e paraburgimit. Oficerët e paraburgimit do të bëjnë më së shumti 3 përpjekje për rivendosjen e lidhjes për çdo vizitë.
 5. Vizitat përmes videolidhjes në OP kryhen në bazë të orareve të përcaktuara dhe të shpërndara gjatë ditës, që caktohen nga NJP-ja për të mundësuar ajrimin e mjaftueshëm të mjedisit ndërmjet vizitave.
 6. Për t'u identifikuar, vizitorët i paraqesin oficerit të paraburgimit një dokument të vlefshëm identiteti me fotografi të pranueshme nga NJP-ja, përkatësisht pasaportë ose letërnjoftim të shtetit përkatës. Në vizitën përmes videolidhjes lejohen të marrin pjesë vetëm personat e miratuar për vizitën e planifikuar përmes videolidhjes. Paraqitja e vizitorëve të pamiratuar mund të shkaktojë përfundimin ose anulimin e menjëhershëm të vizitës përmes videolidhjes.
 7. Vizitorët nuk incizojnë, dërgojnë, transmetojnë, shpërndajnë ose ndajnë me të tjerë asnjë pjesë të vizitës përmes videolidhjes, me asnjë lloj mjeti. Gjatë vizitës përmes videolidhjes, vizitorët nuk bëjnë fotografi, nuk marrin pamje të çastit nga ekrani, dhe as nuk ruajnë pamje apo të dhëna të tjera me asnjë lloj mjeti. Vizitorët raportojnë çdo keqpërdorim ose përdorim të paautorizuar të mjeteve teknike në vizitat përmes videolidhjes.
 8. Mosrespektimi i këtij Udhëzimi nga të paraburgosurit ose vizitorët e tyre mund të çojë në kufizime të vizitave përmes videolidhjes. Ndaj të paraburgosurve që nuk i binden këtij Udhëzimi gjithashtu mund të merren masa disiplinore në përputhje me Udhëzuesin e Punës për Disiplinën, miratuar në bazë të rregullës 63 të Rregullores së Paraburgimit. Ndër masat disiplinore mund të përfshihen pakësimi, ose anulimi tërësor i privilegjit të vizitave përmes videolidhjes të të paraburgosurit.
 9. Vizitat përmes videolidhjes mund të kenë probleme të lidhjes ose vështirësi të tjera teknike. Në këto raste, mund të jetë e pashmangshme që vizita të përfundohet ose anulohet.

Pjesa 6 Gjuha autentike dhe hyrja në fuqi

1. Gjuha autentike e këtij udhëzimi është anglishtja.
2. Ky Udhëzim dhe çdo ndryshim i tij hyjnë në fuqi në ditën e miratimit.

KREU II LLOJET E VIZITAVE PËRMES VIDEOLIDHJES

Pjesa 7 Vizitat prej familjes

1. Të gjithë vizitorët duhet të kenë leje për të bërë vizitë. Ashtu si në rastin e vizitave personale në objektin e paraburgimit, të afërmit e ngushtë duhet të paraqesin kërkesë dhe të marrin leje për vizitë përmes videolidhjes me një të paraburgosur. Sipas rregullës 2.2 të Rregullores së Paraburgimit, të afërm të ngushtë janë bashkëshortja/bashkëshorti, partnerja/partneri, fëmija, fëmija i fëmijës, vëllai, motra (ku përfshihen edhe vëllezër e motra vetëm prej nënës ose babait dhe vëllezër dhe motra të gjetura, gjyshër dhe dhëndri dhe nusja.

Dhomat e Specializuara të Kosovës
Udhëzim i Zyrës Administrative mbi vizitat përmes videolidhjes

KSC-BD-34

2. Procedurat e paraqitjes së kërkesës për leje për vizitë dhe planifikimit të vizitës prej familjes janë të përcaktuara në Udhëzimin e Njesisë së Paraburgimit mbi Procedurat e Vizitave nga Anëtarët e Familjes dhe Vizitorët e tjerë Personalë dhe në Rregulloren e Brendshme.
3. Në bazë të kërkesës dhe nëse është e realizueshme, shefi i paraburgimit mund ta shkurtojë afatin në të cilin një i afërm i ngushtë duhet të paraqesë kërkesë për leje për vizitë ose për planifikimin e vizitës përmes videolidhjes. Gjithashtu, shefi i paraburgimit mund të shkurtojë afatin në të cilin i paraburgosuri duhet të njoftojë zyrën e administrimit se dëshiron të bëjë vizitë përmes videolidhjes me një të afërm të ngushtë.
4. Të afërmit të ngushtë të cilëve u miratohet vizita përmes videolidhjes u jepet informacion si të lidhen me vizitën e planifikuar përmes videolidhjes. Në bazë të kërkesës dhe nëse është e realizueshme, zyra e administrimit mund të organizojë një provë të videolidhjes me të afërmit e ngushtë përpara vizitës së planifikuar përmes videolidhjes.
5. Ashtu si në rastin e vizitave personale në objektin e paraburgimit, vizitat përmes videolidhjes me të afërmit e ngushtë kufizohen në katër të afërmit të ngushtë dhe kryhen brenda rrezes së shikimit dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit. Të paraburgosurit mund t'i kërkohej që gjatë vizitës përmes videolidhjes të qëndrojnë i ulur në një karrige të caktuar në dhomën e vizitës.
6. Gjatë vizitës përmes videolidhjes, oficeri i paraburgimit i vendos tastierën dhe miun e kompjuterit në një dollap të mbyllur me kyç. Të afërmit e ngushtë nuk përdorin asnjë funksion kompjuterik të shkëmbimeve me shkrim apo funksione të tjera të shkrimit të mesazheve me të paraburgosurin gjatë vizitës përmes videolidhjes. Çdo funksion kompjuterik për ndarjen e pamjes së ekranit me të tjerët mund të çaktivizohet.
7. I paraburgosuri nuk lejohet të sjellë sende në një vizitë përmes videolidhjes me të afërmit e ngushtë.
8. Të paraburgosurve u jepet mundësia të kenë më së paku një vizitë përmes videolidhjes në javë me të afërmit e ngushtë. Një vizitë përmes videolidhjes me të afërmit e ngushtë nuk zgjat më shumë se 45 minuta.

Pjesa 8 Vizitat e mbrojtësve

1. Procedurat për organizimin e vizitave të mbrojtësve përmes zyrës së administrimit përcaktohen në nenin 9 të Udhëzimit të Punës për Vizitat e Mbrojtësve dhe në Rregulloren e Brendshme.
2. Mbrojtësve që janë fizikisht të pranishëm në shtetin pritës u jepet informacion për kryerjen e vizitave përmes videolidhjes me një të paraburgosur nëpërmjet një linje komunikimi të sigurt nga zyrat në Raamweg.
3. Ashtu si në rastin e vizitave personale me mbrojtësit në objektin e paraburgimit, vizitat përmes videolidhjes kryhen brenda rrezes së shikimit, por jo brenda rrezes së dëgjimit të oficerëve të paraburgimit. Të paraburgosurit mund t'i kërkohej që gjatë vizitës përmes videolidhjes të qëndrojnë i ulur në një karrige të caktuar në dhomën e vizitës.
4. Të paraburgosurve u jepet mundësia të kenë më së paku një vizitë përmes videolidhjes në ditë me mbrojtësin. Një vizitë përmes videolidhjes me mbrojtësin nuk zgjat më shumë se 120 minuta.

Pjesa 9 Vizitat konsullore

1. Procedurat për marrjen e lejes për vizitë nga përfaqësuesit konsullorë përcaktohen në nenin 20 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet.
2. Pas miratimit nga Administratori, i paraburgosuri mund të kryejë vizitë përmes videolidhjes me përfaqësuesin e vet konsullor nëpërmjet një linje të sigurt komunikimi nga zyrat në Raamweg.
3. Ashtu si në rastin e vizitave me përfaqësues konsullorë në objektin e paraburgimit, vizitat përmes videolidhjes kryhen brenda rrezes së shikimit por jashtë rrezes së dëgjimit të oficerëve të paraburgimit. Të paraburgosurit mund t'i kërkohet që gjatë vizitës përmes videolidhjes të qëndrojnë i ulur në një karrige të caktuar në dhomën e vizitës.

Pjesa 10 Vizitat e posaçme

1. Vizitat me përfaqësues të KNKK-së, Avokatin e Popullit dhe autoritete të tjera rregullohen në pjesën V të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet.
2. Zyra e administrimit organizon vizitën me një të paraburgosur me kërkesë të KNKK-së, Avokatit të Popullit ose autoriteteve të tjera të përcaktuara në nenin 23.1 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet. Pas miratimit nga Administratori, këto vizita përmes videolidhjes mund të kryhen nëpërmjet një linje komunikimi të sigurt nga zyrat në Raamweg.
3. Ashtu si në rastin e vizitave të posaçme në objektin e paraburgimit, vizitat me videolidhje me përfaqësues të KNKK-së, Avokatin e Popullit, dhe autoritetet e përmendura në paragrafin pararendës, kryhen jashtë rrezes së shikimit dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit.

Hagë, Holandë
23 shtator 2020

Dr. Fidelma Donlon
Administratore